



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Edukimit

Pranuar me dt. 30.11.2023			
Nr. Eshkzant	Num	Nr. Ekzant	Vlera
	272111		

Nr.prot. 393 Dt. 24.11.2024

KËSHILLI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT, në mbështetje të nenit 72 dhe 166 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, në bazë të nenit 9 të Rregullores për procedurat e vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm me nr.prot. 1670 datë 28.09.2021 të UIBM, si dhe në bazë të nenit 22 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit me nr.prot. 2816 datë 8.11.2022, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.11.2023 në kuadër të kompetencave ligjore, merr këtë:

VENDIM

- I. **MIRATOHET** Raporti i Komisionit të Ankesave, me nr.prot. 379 datë 20.11.2023 lidhur me ankesën e paraqitur me nr.prot. 374 datë 16.11.2023 të parashtruesit Kadri Mehmeti.
- II. **HIDHET** poshtë si e pabazuar ankesa e parashtruesit Kadri Mehmeti me nr.prot. 374 datë 16.11.2023, ndaj propozim vendimit të Këshillit të Fakultetit me nr.prot. 343 datë 08.11.2023, për konkursin me nr.prot.2067 datë 10.10.2023 publikuar në buletin nr.4 datë 09.11.2023.
- III. Mbetet në fuqi propozim vendimi i Këshillit të Fakultetit me nr.prot. 343 datë 08.11.2023 dhe i dërgohet për miratim Senatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

ARSYETIM

Komisioni vlerësues me datë 30.10.2023 ka përpiluar raportin vlerësues për pozitën VI/6 një asistent për lëndët: Metodologji e leximit letrar, Teori e letërsisë në arsimin fillor, Etnologji dhe letërsi popullore, Letërsi për fëmijë, Histori e letërsisë kombëtare.

Pas pranimit të ankesës së kandidatit Kadri Mehmeti, komisioni i ankesave ka verifikuar dosjen e kandidatit sipas kërkesave të konkursit me nr.prot.2067 datë 10.10.2023 dhe Rregullores me nr.prot.1670 datë 28.09.2021, dhe më pas ka konstatuar se:

Sa i përket pikës së ankesës se “Këshilli i Fakultetit nuk ka respektuar rregulloren me nr.prot. 1670, datë 28.09.2021 në lidhje me kushtet e angazhimit”, komisioni konstaton se: Propozim vendimi i Këshillit të Fakultetit të Edukimit me nr.prot. 343 datë 08.11.2023, e përmban qartë sqarimin e nenit 7 të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM.

Andaj si pikë e lartëcekur e ankesës është e pabazuar.

Prandaj, Këshilli i Fakultetit të Edukimit pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit të Ankesave, dhe të cekurave si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i’u dërgohet:

Parashtruesit të ankesës
Zyrës për çështje akademike
Arkivës së Fakultetit

Kryesuesja e Këshillit të Fakultetit

Prof.ass.dr. Samirë Bllaca Balaj





UNIVERSITETI I MITROVICË
"ISA BOLETINI"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Pranuar me dt. 20/11/2023			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
UNIVERSITETI I MITROVICË "ISA BOLETINI" FAKULTETI I EDUKIMIT	379		

Nr. Prot. _____ Dt _____

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit me nr. Prot. 254 të datës 20.10.2023 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" të datës 10.10.2023 me Nr. Prot. 2067. Komisioni është mbledhur me datën 20.10.2023 për të shqyrtuar ankesën e Kadri Mehmeti e paraqitur me Nr. Prot. 374 të datës 16.11.2023, pas shqyrtimit të dokumentacionit komisioni i lartëcekur përpiloi këtë:

R A P O R T

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** Ankesa e parashtruar me Nr. Prot. 374 të datës 16.11.2023 nga kandidati Kadri Mehmeti.

Arsyetim

Komisioni vlerësues me datë 30.10.2023 ka përpiluar raportin vlerësues për pozitën VI/6 një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e leximit letrar, Teori e letërsisë në arsimin fillor, Etnologji dhe letërsi popullore, Letërsi për fëmijë, Histori e letërsisë kombëtare.

Sa i përket ankesës së kandidatit Kadri Mehmeti komisioni i ankesave ka verifikuar dosjen e kandidates sipas kërkesave të konkursit dhe më pas ka konstatuar se:

Sa i përket pikës së ankesës se "Këshilli i Fakultetit nuk ka respektuar rregullorën me nr. 1670, dt. 28.09.2021 në lidhje me kushtet e angazhimit", komisioni konstaton se: Propozimi vendimi i Këshillit të Fakultetit të Edukimit me Nr. Prot. 343, dt. 08.11.2023, sqaron pikën 6.2 të nënit 7 të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM.

Andaj si pikë e lartëcekur e ankesës është e pabazuar.

Komisioni i ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit, që të refuzohet ankesa në fjalë si e pabazuar.

Komisioni:

Prof. dr. Qerim Selimi, Kryetar _____

Ass. Hatixhe Gashi, Anëtare _____

Ass. Ylli Hashani, Anëtar _____

Handwritten signatures in blue ink over horizontal lines. The first signature is for Hatixhe Gashi, and the second is for Ylli Hashani.

Raporti iu dërgohet:

Arkivës së Fakultetit

Këshillit të Fakultetit

Parashtrueses së ankesës



UNIVERSITETI I MITROVICËS
"ISA BOLETINI"
FAKULTETI I EDUKIMIT

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT

Pranuar me dt.	20/11/2023		
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
	380		

Nr. Prot. _____ Dt _____

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit me nr. Prot. 254 të datës 20.10.2023 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" të datës 10.10.2023 me Nr. Prot. 2067. Komisioni është mbledhur me datën 20.10.2023 për të shqyrtuar ankesën e Kadri Mehmeti e paraqitur me Nr. Prot. 374 të datës 16.11.2023, pas shqyrtimit të dokumentacionit unë si kryetar i Komisionit te lartcekur përpiloi raport :

- I. **Aprovohet si e bazuar** Ankesa me Nr. Prot. 374 të datës 16.11.2023 nga kandidati Kadri Mehmeti.

Arsyetim

Kandidati Kadri Mehmeti i plotëson te gjitha kushtet e paraqitura ne konkursin e datës 10.10.2023 me numër protokolli 2067.

Unë si kryetar i Komisionit te ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit, që të pranoj te bazuar ankesën e kandidatit dhe pranoi propozimin e komisioni vlerësues te datës 10.10.2023 me numër protokolli 2067 që te angazhoi MSc. Kadri Mehmentin ne pozitën e asistenti për lendet e shpallura ne konkurs.

Mitrovicë

20.11.2023

Prof. dr. Qerim Selimi, Kryetar

Raporti iu dërgohet:

Arkivës së Fakultetit

Këshillit të Fakultetit

Parashtrueses së ankesës